

INICIATIVAVE E BURRAVE TË RINJ

Sondazhi i Opinionit Publik mbi Edukimin për Aftësi Jetësore në Ballkan

Future 4 YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Edukimi për Shkathtësi Jetësore është i nevojshëm urgjentisht në arsimin formal në Ballkan për të ndërtuar aftësitë e brezave të ardhshëm për të zhvilluar marrëdhënie të shëndetshme bazuar në barazinë gjinore, për të kuptuar zhvillimin e tyre fizik dhe emocional dhe për të adresuar të gjitha format e dhunës në jetën e tyre të përditshme.

Sipas hulumtimit Endline të kryer nga CARE në 25 shkolla të mesme në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Serbi në vitin 2020, hendeuku i aftësive rezultues po kontribuon në keqkuptimin e dhunës që mund të rezultojë në rritje të sjelljes së dhunshme dhe tolerancë më të lartë ndaj saj, dhe shumë aspekte të jetës të tilla si vijimi i shkollës dhe arritjet akademike, funksionimi social, pjesëmarrja në sporte dhe shfrytëzimi i mundësive të punësimit. Duke marrë parasysh që shkathtësitë jetësore janë mjet i rëndësishëm për t'i pajisur të rinjtë me të, është sigurisht e rëndësishme që t'i mësojmë të rinjtë për barazinë gjinore, mënyrat e shëndetshme të jetesës, dhe llojet e ndryshme të dhunës dhe pasojave, dhe kështu, të mundësohet një mjedis pozitiv për të rinjtë në Ballkan.

Në përputhje me këtë, CARE ka kryer hulumtime rajonale të opinionit publik në vitin 2019 në lidhje me domosdoshmërinë e integritit të edukimit të shkathtësive të jetës si pjesë e arsimit formal. Analiza bazohet në të dhënat e mbledhura mbi opinionet e popullatës së synuar, duke rezultuar në një mendim të lartë, gatishmëri për të mbështetur dhe vlerësim të lartë të edukimit për aftësitë jetësore në Ballkan.

MOSTRA E SONDAZHIT

BOSNJE DHE HERCEGOVINA

700 të anketuar

SERBIA

1100 të anketuar

KOSOVA

700 të anketuar

Grupet e synuara të sondazhit ishin nxënës të shkollës së mesme, prindër të nxënësve të shkollave të mesme, mësimdhënës të shkollave të mesme, profesionistë në institucionet publike, shoqëria civile, mediat dhe punëdhënësit. Gjetja më e rëndësishme është që shumica absolute e tyre mendojnë se edukimi për aftësitë jetësore është i domosdoshëm për të rinjtë dhe që mesatarisht 90% mendojnë se arsimi për shkathtësitë jetësore duhet të jetë pjesë e detyrueshme e arsimit.



Kosova



Bosnja dhe Hercegovina



Serbia

PUNËDHËNËSI

98%

INSTITUCIONET PUBLIKE

94%

NXËNËS TË SHKOLLËS SË MESME

88%

98%

SHOQËRIA CIVILE

MEDIA

93%

91%

PRINDËR TË NXËNËSVE TË SHKOLLËS SË MESME

90%

MËSIMDHËNËSIT NË SHKOLLA TË MESME

INICIATIVAVE E BURRAVE TË RINJ


Sondazhi i Opinionit Publik mbi Edukimin për Aftësi Jetësore në Ballkan

Future 4 YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Përveç kësaj gjetjeje kryesore, rezultatet treguan se në nivel rajoni, parandalimi i abuzimit me dhe drogën alkoolin konsiderohet si një nga temat më të rëndësishme shoqërore.



Në nivel vendi, grupet e synuara kanë renditur rëndësinë e temave sociale si më poshtë.

Bosnjë dhe Hercegovinë – Parandalimi i dhunës dhe komunikimi jo i dhunshëm shihet si çështja më e rëndësishme

Kosovë – Parandalimi i drogës dhe abuzimit me alkoolin dhe parandalimi i dhunës dhe komunikimi jo i dhunshëm shihen si çështjet më të rëndësishme

Serbia - Parandalimi i drogës dhe abuzimit me alkoolin shihet si çështja më e rëndësishme

CARE International dhe organizatat partnere nga Ballkani përmes Inicativës së Burrave të Rinj (YMI) kanë prezantuar programe edukimi për shkathtësitë jetësore që synojnë promovimin e barazisë gjinore dhe stilet e shëndetshme të jetesës me të rinj dhe të reja duke adresuar disa nga konstruksionet sociale të maskulinitetit(ve) dhe feminitetit(ve) si një strategji për ndërtimin e shkathtësive të rëndësishme jetësore tek të rinjtë dhe të rejat kur arrijnë pjekuri të hershme.

Programi Y - programi transformues gjinor është zbatuar në mbi 130 shkolla fillore dhe të mesme në Ballkan.

- **Programi Y** është akredituar nga Ministritë e Arsimit në Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Kosovë dhe Kroaci. Për më tepër, Programi Y është bërë i detyrueshëm në Kantonin Hercegovinë-Neretva dhe Boshnjak-Podrinje, duke qenë 25% pjesë e detyrueshme e orës së parë;
- Mbi 1,600 mësues u trajnuan në manualin e Programit Y deri më tani dhe mbi 120,000 nxënës të shkollës së mesme morën pjesë në zbatimin e Programit Y në shkollat e mesme në rajon.

Të dhënat tregojnë qartë domosdoshmërinë dhe gatishmërinë e të gjitha grupeve të synuara për miratimin e arsimit për shkathtësitë e jetës në kurrikulën e shkollës së mesme. CARE dhe partnerët e saj në të gjithë Ballkanin kanë inicuar lëvizjen "Future 4 Youth (E ardhmja për të rinjtë)" e cila synon të sjellë zëra të ndryshëm të shoqërisë civile, grupe joforale të qytetarëve, prindër, mësues dhe akterë të tjerë rreth të njëjtit qëllim - për të adresuar dhe avokuar për parandalimin e dhunës, barazinë gjinore, shkathtësitë jetësore dhe edukimin shëndetësor në shkollat në të gjithë Ballkanin.

KONTAKTONI

Për më shumë informacion na kontaktoni përmes info@youngmeninitiative.net

<http://youngmeninitiative.net/en>

<https://www.facebook.com/youngmeninitiative>

<http://care-balkan.org/>

<https://www.instagram.com/yminitiative>

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

Mbështetur nga:



Partnerët:

